REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DHURATA VARDHAMI
ADRESA RR. SAMI FRASHERI
TEL: 0674110083

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 773** **Nr. koleksioni: 269**

**Tirane më 09/06/2022**

Ornela Pango
Digitally signed by Ornela Pango
Date: 2022.06.20 04:04:55 +02'00'

A2022054130030912562

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

Endrit Habilaj
Digitally signed by Endrit Habilaj
Date: 2022.06.14 09:34:46 +02'00'

*Akti noterial përbëhet nga ... faqe

TAKSAE PULLES
U PAGUA

A2022054130030912562

# KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

( *Të Shoqërisë "Infinit Communication" shpk*)

Sot, më datë 9/06/2022, para meje Notere Dhurata Vardhami, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Rr. Sami Frashëri, u paraqit personalisht:

**Z. Endrit Habilaj**, atësia Kudret, amësia Fatbardha, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "V Pasha"; Pall15 Shk3 Ap21; Nd. 1816; H. 0; Ap. 032; Njësia Bashkiake Nr. 5; i datëlindjes 10/03/1988, i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037392391 dhe nr. personal I80310077T, **(në vijim "Shitësi"); .**

**BLERES**:
**Znj.Ornela Pango,** atësia Agim, amësia Antigoni, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Sulejman Delvina; Nd. 10; H. 1; Njësia Bashkiake Nr. 5; e datëlindjes 13/01/1981, e martuar, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038075915 dhe nr. personal I15113109C, **(në vijim "Bleresi")..**

Shitësi dhe Bleresi në vijim referuar së bashku **"Palët"** dhe veçmas si **"Pala".**

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Neni 1
Kushte Paraprake të Përgjithshme

Shoqëria "Infinit Communication" sh.p.k e regjistruar në QKR me Nr. NIPTI L91331028L aktualisht me adresë: Tiranë, Kashar Mezez, Rruga "17 Nëntori", Godina nr.20, Kati i II-të. me kapital 100% shqiptar ku 50% të pjesëve të kapitalit të saj, në vlerë 50 000 (pesëdhjetëmijë) Lekë zotërohet nga ortaku Endrit Habilaj dhe 50% të pjesëve të kapitalit të saj, në vlerë 50 000 (pesëdhjetëmijë) Lekë zotërohet nga ortaku Znj.Ornela Pango.

Ornela Pango
Digitally signed by Ornela Pango
Date: 2022.06.20 04:04:55 +02'00'

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Infinit Communication" sh.p.k, mbajtur në adresen e sipërcituar me datën /06/2022, është vendosur:

***Transferimi i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" sh.p.k, që i përkasin Z. Endrit Habilaj në dobi të Znj. Ornela Pango.***

Shitësi Endrit Habilaj dëshiron t`ë shesë dhe transferojë te Bleresi, Zj. Ornela Pango, 1 (një) kuotë e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k.

dhe

Endrit Habilaj
Digitally signed by Endrit Habilaj
Date: 2022.06.14 09:34:46 +02'00'

Blerësi Znj.Ornela Pango dëshiron të blejë nga Shitësi Z.Endrit Habilaj 1 (një) kuotë që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k.

## Neni 1
## Objekti i Kontraës

**Transferimi me shitje** 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k.

## Neni 2
## Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës

Vlera e 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k do të jetë 50 000 (pesëdhjetëmijë) Lek. (në vijim "**Çmimi i Shitjes**").

## Neni 3
## Kalimi i titullit të pronësisë dhe posedimit

Më nënshkrimin e kësaj Kontrate Zj. Ornela Pango, do të rezultojë pronare e kuotës së vetme që përfaqëson 100% (një qind për qind) të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k.

Zj. Ornela Pango, do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) si Ortake e Vetme e shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k duke përfaqësuar 100% (një qind për qind) të kapitalit të shoqërisë "Infinit Communication" Sh.p.k.
Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga shitësi te blerësi, shitësi nuk do të jetë ortak i shoqërisë "Infinit Communication" shpk.

## Neni 4
## Deklarime dhe garanci

<u>**Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:**</u>
Shitësi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i Pasurisë së Luajtshme identifikuar në dokumentet bashkëngjitur, titulli i pronësisë mbi të është fituar në mënyrë të ligjshme, dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontrate, dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj. Shitësi është i vetmi pronar i ligjshëm i Pasurisë së identifikuar në pikën A, më sipër dhe ka të drejtë të lidhë këtë Kontrate e të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj.
Shitësi deklaron dhe garanton se Pasuria identifikuar në dokumentet bashkëngjitur, është e lirë nga çdo barrë apo kufizim;

Ornela Pango
Digitally signed by Ornela Pango
Date: 2022.06.20 04:04:55 +02'00'

Ne lidhje me pasurinë nuk ka procese administrative apo gjyqësore;
Shitësi i jep Blerësit garancitë më të plota të eviksionit të parashikuara me ligj.
Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi dhe përmbushja prej tij e detyrimeve të marra përsipër nuk shkel, cënon apo është ne konflikt me detyrime që Shitësi ka marrë përsipër sipas marrëveshjeve apo kontratave me të tretë në lidhje me Pasurinë apo pjesë të saj.

<u>**Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:**</u>
Kjo Kontratë përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe të ekzekutueshëm për Blerësin dhe Blerësi i ka të gjithë të drejtat të lidhë këtë Kontrate dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.
Blerësi do të paguajë të gjithë Çmimin e Shitjes sipas parashikimeve të kësaj Kontrate. Blerësi deklaron e garanton se fondet e nevojshme për blerjen e Pasurisë i ka siguruar nga biznesi i tij si person fizik.

Endrit Habilaj
Digitally signed by Endrit Habilaj
Date: 2022.06.14 09:34:46 +02'00'

A2022054130030912562

Blerësi do te përballojë të gjitha shpenzimet në lidhje me tarifat, tatimet, kostot dhe shpenzimet që lidhen me apo rezultojnë nga kalimi i pronësisë, përfshirë pa kufizim shpenzimet noteriale, Blerësi autorizon noterin për të kryer të gjithë veprimet për depozitimin për regjistrimin e kësaj kontrate në QKB.

**Neni 5**
**Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni**

Kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Çdo çështje që nuk gjen rregullim në këtë Kontrate do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që mund të lind midis Shitësit dhe Blerësit në lidhje me këtë Kontrate dhe që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 6**
**Anekset**

Kësaj kontrate i bashkëngjiten:
Ekstraktet e regjistrit tregtar dhe dokumentet e identifikimit të Shitësit;
Formulari i rregistrit te barreve siguruese.

**Dispozita Përfundimtare**

Kontrata e shitjes pasuri e luajtshme - Apartament u hartua në gjuhën shqipe prej meje Noteres në 4 (katër) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, një kopje depozitohet në institucionin e regjistrimit të pasurive të luajtshme, QKB, për t'u regjistruar dhe dy kopjet e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

Kontrata e Shitjes pasuri e luajtshme - Kuotë kapitali, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Ornela Pango
Digitally signed by Ornela Pango
Date: 2022.06.20 04:04:55 +02'00'

**Shitësi** **Blerësi**

Endrit Habilaj

**NOTERE**

Ornela Pango

Endrit Habilaj
Digitally signed by Endrit Habilaj
Date: 2022.06.14 09:34:46 +02'00'